



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA E INFORMACIONIT DHE PUBLIKIMIT**

Nr. 5391 Prot.

Tiranë, më 18.05.2018

NJOFTIM

Drejtuar: Autoriteteve kontraktore

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") sjell në vëmendje të autoriteteve kontraktore, se në zbatim të dispozitave ligjore të prokurimit publik, regjistrat e realizimeve të procedurave të prokurimit publik, nuk duhet të dërgohen për publikim në formë shkresore dhe me CD pranë APP.

Sa më sipër, referuar parashikimeve të nenit 4, të ndryshimeve të fundit të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", regjistri i parashikimeve dhe realizimeve krijohet vetëm në sistemin e prokurimit elektronik nga vet autoriteti kontraktor .

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

